Paneli këshillëdhënës për të drejtat e njeriut
Building D, UNMIK HQ, Prishtinë/Kosovë | E-mail: hrap-unmik@un.org | Tel: +381 (0)38 504-604, ext. 5182

MENDIM

Data e miratimit: 6 qershor 2013

Lënda nr. 308/09

Millorad RAJOVIQ

kundër

UNMIK-ut

Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut, i mbledhur më 6 qershor 2013,
me pjesëmarrjen e këtyre anëtarëve:

Z. Marek NOWICKI, kryesues
Znj. Christine CHINKIN
Znj. Françoise TULKENS

Të ndihmuar nga

Z. Andrey Antonov, zyrtar ekzekutiv

Pasi mori parasysh ankesën e lartpërmendur, e parashtruar në pajtim me nenin 1.2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, të datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut,

Pas shqyrtimit të vëmendshëm, paraqet gjetjet dhe rekomandimet si në vijim:

I. PROCEDURAT PARA PANELIT

1. Ankesa është paraqitur më 7 shtator 2009 dhe është regjistruar më 14 shtator 2009.

2. Më 17 shtator 2009, Paneli pranoi informata të mëtejme nga Avni Q. Vula, përfaqësues ligjor i ankuesit.

3. Më 22 maj 2010, Paneli kërkoi informata shtesë nga ankuesi. Nuk u pranua asnjë përgjigje.

4. Më 18 shtator 2012, Paneli për ankesën e njoftoi Përfaqësuesin Special të Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP), lidhur me dhënien e komenteve të UNMIK-ut mbi pranueshmërinë e rastit. Më 1 nëntor 2012, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

5. Më 9 nëntor dhe 4 dhjetor 2012, Paneli kërkoi informata shtesë nga Misioni i OSBE-së në Kosovë (OMIK). Më 15 nëntor dhe 14 dhjetor 2012, OMIK-u dha përgjigjen e vet.

6. Më 18 dhjetor 2012, Paneli kërkoi komente shtesë mbi pranueshmërinë e ankesës nga PSSP-ja. Më 10 janar 2013, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

7. Më 31 janar 2013, Paneli e shpalli ankesën të pranueshme.

8. Më 4 shkurt 2013, Paneli ia përcolli PSSP-së vendimin e vet për pranueshmërinë, duke kërkuar komentet e UNMIK-ut mbi bazueshmërinë e ankesës. Më 26 mars 2013, PSSP-ja dha përgjigjen e UNMIK-ut.

II. FAKTET

9. Ankuesi është pronar i ndërmarrjes "Udarnik Komerc SH.P.K.", e cila ka në pronësi një pronë në Pejë.

10. Më 29 shkurt 2000 dhe përsëri më 8 korrik 2000, në pajtim me rregullat, në bazë të të cilave qeverisen prona shoqërore dhe ajo publike, UNMIK-u e autorizoi OMiK-un që të marrë këtë pronë me besimin që këto objekte ishin pronë shoqërore.

11. Më 1 mars 2000, OMiK e mori këtë pronë si pjesë të zyrave të veta rajonale në kuadër të komunës. Ankuesi deklaron që pasi OMiK i mori objektet, ai menjëherë i informoi ata se objektet i takonin atij dhe që duhet bërë ndonjë formë e marrëveshjes për qiradhënie. Ankuesi pohon që gjatë kësaj periudhe dhe deri më 1 nëntor 2007, nuk u arrit asnjë marrëveshje për qiradhënie apo paguar qiraja atij përmes ndërmarrjes së tij.

12. Më 1 nëntor 2007, ndërmarrja e ankuesit nënshkroi një kontratë për t'ia dhënë me qira objektet e njëjta OMIK-ut, për kushtet e së cilës u arrit pajtimi deri më tani. Ankuesi pohon, megjithatë, që ai nuk kishte qenë në gjendje të hyjë në negociata me OMIK-un lidhur me zënien e objekteve mes 1 marsit 2000 dhe 1 nëntorit 2007 dhe pagesës së qirasë për datat më të hershme që ishin borxh ndaj ndërmarrjes.

III. ANKESA

13. Duke pasur në konsideratë shpalljen e ankesës të pranueshme, ankuesi në esencë pohon që mospagesa nga OMiK-u paraqiste shkelje të së drejtës së tij për të zotëruar i patrazuar pronën e tij, e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

IV. LIGJI

A. Parashtresat e palëve

Parashtresat e ankuesit

14. Ankuesi i referohet mospajtimit të OMiK-ut që të paguajë qiranë për shfrytëzimin e objekteve në Pejë, për periudhën 1 mars 2000 deri më 1 nëntor 2007.

15. Në këtë drejtim siç është treguar më lart, ankuesi mbështetet në shkeljen e së drejtës së tij të zotërojë i patrazuar pronën e tij, e drejtë e garantuar me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ-së).

Parashtresat e UNMIK-ut

16. Në komentet e tij mbi bazueshmërinë e ankesës, PSSP-ja pranon që roli i OMiK-ut në Kosovë ishte si një mbështetje e dallueshme nga UNMIK-u dhe që zënia nga ana e tij e objekteve në Pejë ndodhi gjatë ushtrimit të mandatit të UNMIK-ut që pasoi pas miratimit të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Megjithatë, PSSP-ja argumenton që duhet bërë një dallim ndërmjet mandatit të UNMIK-ut dhe implementimit të brendshëm të një mandati të tillë.

17. PSSP-ja thotë që OMiK-u, si një organizatë ndërqeveritare me buxhet dhe administratë të veçantë, nuk i nënshtrohej në asnjë mënyrë ndërhyrjes apo udhëzimit të UNMIK-ut. Duke iu referuar vendimit të Panelit në rastin *Jovanoviq*, nr. 39/08, vendimi i 17 tetorit 2008, PSSP-ja argumenton që OMiK-u duhet konsideruar si organizatë e veçantë, ndryshe nga UNMIK-u dhe që UNMIK-u nuk dinte dhe nuk ishte përgjegjës për përzgjedhjen e objekteve që do të shfrytëzoheshin nga OMiK-u. Ajo që është më e rëndësishme, UNMIK-u nuk mori pjesë kurrë në ndonjë "diskutim të brendshëm me OMiK-un lidhur me objektet e veta dhe as që kishte mundësinë apo të drejtën të ndikojë në vendimet e tij administrative".

18. PSSP-ja e pranon që autorizimi fillestar për të zënë objektet në Pejë i ishte dhënë OMiK-ut nga UNMIK-u (shih § 10 më lart). Një autorizim i tillë, argumenton PSSP-ja, është dhënë duke u bazuar në dëshminë e marrë nga regjistrimet kadastrale që tregonin se prona ishte në pronësi të "Ndërmarrjes Publike Banesore", si një ndërmarrje që besohej të ketë qenë pronë shoqërore. PSSP-ja shton, megjithatë, që në kohën e autorizimit të dyja, përkatësisht UNMIK-u dhe OMiK-u, nuk ishin në dijeni për "të drejtën e pretenduar titullare të ankuesit në pronë".

19. PSSP-ja argumenton më tutje që, në pajtim me procedurat operative të të gjitha organizatave ndërkombëtare, çdo shpenzim apo borxh i shkaktuar duhet trajtuar përmes procedurave të brendshme të miratuara. Prandaj sa i përket OMiK-ut, çdo shpenzim apo borxh i shkaktuar duhet adresuar në selinë e saj në Vjenë., "UNMIK-u nuk di për vendimet e marra nga selia e OSBE-së në Vjenë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me pagesat e qirasë për Misionin e OSBE-së".

20. PSSP-ja pastaj i referohet vendimit të Panelit për pranueshmërinë e këtij rasti, të datës 31 janar 2013. Ai përmend dallimin e bërë nga Paneli ndërmjet zënies së objekteve nga OMiK-u para dhe pas nëntorit të vitit 2007 dhe konkludon që gjithë kohën ai ushtroi "funksionet e njëjta nën mandatin e UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1244 (1999), ashtu siç bëri kur OMiK-u filloi zënien e objekteve në fjalë në vitin 2000".

21. PSSP-ja përfundon që ankesa është e papranueshme dhe si pasojë duhet hedhur poshtë nga Paneli me bazë se nuk ka kompetencë të gjykojë për çështjet e lidhura me aktivitetet administrative të OMiK-ut. Si rezultat, asnjë shkelje e së drejtës së ankuesit për të zotëruar i patrazuar pronën e tij nuk mund t'i atribuohet UNMIK-ut.

B. Vlerësimi i Panelit

Observim preliminar

22. Para se ta shqyrtojë bazueshmërinë e ankesës, Paneli duhet ta qartësojë fushën e shqyrtimit.

23. Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut nr. 2006/12, e datës 23 mars 2006, mbi themelimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut siguron që Paneli ka juridiksion mbi ankesat për shkelje të pretenduara të të drejtave të njeriut "që kanë ndodhur jo më herët se 23 prill 2005 apo që rrjedhin nga faktet të cilat kanë ndodhur para kësaj date, ku këto fakte shkaktojnë një shkelje të vazhdueshme të të drejtave të njeriut". Pra, ngjarjet që kanë ndodhur para 23 prillit 2005, përgjithësisht janë jashtë juridiksionit *rationetemporis* të Panelit. Megjithatë, në rastin kur ngjarjet e tilla kanë shkaktuar një situatë të vazhdueshme, Paneli ka juridiksion t'i shqyrtojë ankesat që ndërlidhen me atë situatë por vetëm nëse situata ka vazhduar pas 23 prillit të vitit 2005**.**

24. Paneli e krahason këtë me nënshkrimin e një kontrate ndërmjet ankuesit dhe OMiK-ut për periudhën që fillonte më 1 nëntor 2007. Në atë fazë, një marrëdhënie private kontraktuale u arrit ndërmjet palëve për shfrytëzimin e objekteve nga OMiK-u. Çdo mosmarrëveshje për sa u përket afateve dhe kushteve të kësaj kontrate do të vlerësohej pastaj si çështje private kontraktuale më parë, sesa çështje me një bartës të funksioneve për të cilat UNMIK-u e kishte përgjegjësinë përfundimtare.

Marrëdhënia organizative ndërmjet UNMIK-ut dhe OMiK-ut

25. Paneli rikujton që OMiK u themelua më 1 korrik 1999. Vendosja e tij kishte për bazë Vendimit e Këshillit të Përhershëm nr. 305 (VENDIMI/ K.P./DHJETOR/305), i cili i referohej Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) dhe e ngarkoi Misionin me aktivitetet që kanë të bëjnë me ndërtimin e institucioneve dhe demokracisë dhe të drejtat e njeriut si një "komponent i dallueshëm brenda kornizës së përgjithshme të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë".

26. Paneli thekson më tutje që Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së i 12 qershorit 1999, më vonë i konfirmuar me Vendimin e Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 305 (shih më lart), pranoi rolin që OSBE-ja do të luante në Kosovë nën udhëheqjen e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. Paragrafi 3 i këtij raporti thoshte që "Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm do të ketë autoritetin e përgjithshëm për të drejtuar Misionin dhe t'i bashkërendojë aktivitetet e të gjitha agjencive të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe organizatave tjera ndërkombëtare si pjesë e UNMIK-ut" (S/1999/672). Kjo u konfirmua më tej më 12 korrik 1999, në Raportin e Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara të asaj date, i cili e fuqizoi UNMIK-un si organizatë udhëheqëse në administrimin e Kosovës dhe pozitën e OMiK-ut brenda kësaj strukture (S/1999/779).

27. Paneli i referohet shkëmbimit të letrave ndërmjet nënsekretarit të përgjithshëm për operacione paqeruajtëse të OKB-së, ambasadorit Bernard Miyet dhe ambasadorit Kim Traavik, përfaqësues i presidentit në detyrë të OSBE-së, i datës 16 dhe 19 korrik 1999, i cili përmend një marrëveshje lidhur me ndarjen e detyrave që do të kryhen nga OMiK-u nën UNMIK-un[1]. Letra konfirmoi në mes tjerash që komponenti i UNMIK-ut për ndërtim të institucioneve do të udhëhiqej nga zëvendës përfaqësuesi special i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, i cili do të jetë udhëheqës i OMiK-ut. Në cilësinë e tij/saj si zëvendës i PSSP-së, ai/ ajo gjithashtu do t'i raportonte PSSP-së për aktivitetet e komponentit për ndërtim të institucioneve. PSSP-ja gjithashtu do të ruante autoritetin e përgjithshëm dhe të drejtpërdrejtë për interpretimin dhe implementimin e dispozitave të Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999) në lidhje me aspektet e saj civile. PSSP-ja do të kishte përgjegjësinë për të siguruar që të gjitha aktivitetet e UNMIK-ut, duke përfshirë komponentin për ndërtim të institucioneve të udhëhequr nga OSBE-ja, do të kryhen në një mënyrë të integruar, kohezive dhe efektive.

28. Në të vërtetë, Paneli thekson, që në raportet e tij për Këshillin e Sigurimit mbi aktivitetet e ndërmarra nga UNMIK-u në Kosovë, Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së shpesh u referohej veprimeve të OMiK-ut gjatë juridiksionit të Panelit. Shih për shembull raportet tremujore të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së mbi Misionin e Administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë, 3 janar 2008.

29. Prandaj, Paneli përfundon që megjithëse OMiK-u përfaqësonte shtyllë të dallueshme të pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përgjegjësia për aktivitetet e tij të përgjithshme mbeti në kuadër të UNMIK-ut.

Aktivitetet e OMiK-ut

30. Në lidhje me aktivitetet e OMiK-ut, Paneli bën një dallim ndërmjet aktiviteteve të tij private kontraktuale dhe veprimeve publike, të bëra si pjesë e rolit të tij si një shtyllë e UNMIK-ut në Kosovë. Periudha mes 1 marsit 2000 dhe 1 nëntorit 2007, gjatë së cilës OMiK-u mori objektet e ndërmarrjes së ankuesit pa marrëveshjen dhe pajtimin e qartë për qëllime të kryerjes së aktiviteteve të veta publike, duhet të shihet në kontekst të kryerjes së një veprimi në lidhje me rolin e UNMIK-ut në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999). Nuk u bë asnjë marrëveshje e qartë apo e vetëkuptuar me ndërmarrjen e ankuesit për shfrytëzimin e objekteve si pjesë e operacionit të OMiK-ut në Pejë gjatë kësaj periudhe. Në të vërtetë, autoriteti i OMiK-ut mbi objektet e tilla në këtë kontekst mund të rrjedhë vetëm nga përfshirja e tij brenda kornizës administrative të UNMIK-ut (shih § 15 deri 17 më lart) dhe Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244 (1999).

Parimet e përgjithshme

31. Në nenin 1 të Protokollit nr.1 të KEDNJ-së, në pjesën relevante, thuhet,

"Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të zotërojë i patrazuar pronat e tij. Askujt nuk duhet t'i merren pronat e tij, përveç për interes publik dhe sipas kushteve të parapara me ligj dhe parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare. Dispozitat paraprijëse,

[1]Shih *OSBE-ja në ambientin e ri ndërkombëtar në Kosovë*, Marcin Czapliński, *http://www.core-hamburg.de/documents/yearbook/english/09/Czaplinski-en.pdf*, Qendra për hulumtim e OSBE-së, Vjetari i OSBE-së 2009.

megjithatë nuk zvogëlojnë në asnjë mënyrë të drejtën e një shteti që t'i zbatojë ligjet e tilla si e sheh të nevojshme për të kontrolluar shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm apo për të siguruar pagesën e taksave dhe kontributeve apo dënimeve tjera*".*

32. Së pari, Paneli duhet të shqyrtojë çështjen nëse ka pasur ndërhyrje në të drejtën e ankuesit për të zotëruar i patrazuar pronën e tij prej 23 prillit 2005, periudha e cila shënon fillimin e juridiksionit të Panelit, deri më 1 nëntor 2007.

33. Paneli thekson që PSSP-ja dhe OSBE-ja nuk e kundërshtojnë pronësinë ndaj objekteve në fjalë. Siç është treguar nga ankuesi, prona ishte blerë nga ai në vitin 1993 dhe ishte vërtetuar nga gjykata kompetente me nr. 2767/93. Më vonë, më 1 nëntor 2007, OSBE-ja e bëri një kontratë për qira me kompaninë e ankuesit për marrjen e objekteve.

34. Prandaj, Paneli përfundon që zënia e objekteve në Pejë nga OMiK-u, prej 1 marsit 2000 deri më 1 nëntor 2007, e pengoi ankuesin që të merret me pronën e tij ashtu si ai e ka parë të arsyeshme dhe në këtë mënyrë përbënte një ndërhyrje në pajtim me nenin 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së.

35. Përveç kësaj, Paneli duhet të përcaktojë nëse kjo ndërhyrje ka paraqitur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së. Paneli rikujton praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut:

> "… Neni 1 i Protokollit nr. 1 përmban tri rregulla të dallueshme: rregulla e parë, e vendosur në fjalinë e parë të paragrafit të parë, është e një natyre të përgjithshme dhe shpall parimin e zotërimit të patrazuar të pronës; rregulla e dytë, e vendosur në fjalinë e dytë të paragrafit të parë, mbulon privimet nga pronat dhe ia nënshtron këtë kushteve të caktuara; rregulla e tretë, e vendosur në paragrafin e dytë, pranon që shtetet kontraktuese kanë të drejtë, në mes tjerash, të kontrollojnë shfrytëzimin e pronës në pajtim me interesin e përgjithshëm. Tri rregullat, megjithatë, nuk janë të dallueshme në kuptimin që të jenë të shkëputura. Rregulla e dytë dhe e tretë kanë të bëjnë me shembujt e veçantë të ndërhyrjes në të drejtën për zotërim të patrazuar të pronës dhe së këndejmi duhet të shpjegohen në dritë të parimit të përgjithshëm të shpallur në rregullën e parë" (shih, p.sh.,GJEDNJ (Dhoma e Lartë), *Perdigao kundër Portugalisë*, nr. 24768/06, vendimi i gjykatës, 16 nëntor 2010, § 57).

36. Paneli thekson që aktivitetet e OMiK-ut nuk përfshijnë privimin nga prona në kuadër të kuptimit të fjalisë së dytë të paragrafit të parë të nenit 1, sepse ankuesi, përmes ndërmarrjes së tij, mbeti pronar ligjor i objekteve në Pejë. Paneli konsideron që zënia e objekteve përbënte kontroll të shfrytëzimit të pronës, në kuadër të kuptimit të paragrafit të dytë të nenit 1 të Protokollit nr. 1 (shih GJEDNJ, *Mellacher kundër Austrisë*,vendimi i gjykatës, 19 dhjetor 1989, Seria A, nr. 169, § 44; GJEDNJ, *Matos E Silva, LDA dhe të tjerët kundër Portugalisë*, nr. 15777/89, vendimi i gjykatës,16 shtator 1996, § 79;*Gasus Dosier dhe Fördertechnik GmbH kundër Holandës*, nr. 15375/89, vendimi i gjykatës, 23 shkurt 1995, § 57; *Doğan kundër Turqisë*, nr. 8803-8811/02, 8813/02 dhe 8815-8819/02, vendimi i gjykatës, 29 qershor 2004, § 143, GJEDNJ 2004-VI).

37. Përveç kësaj, Paneli duhet të shqyrtojë ligjshmërinë e ndërhyrjes.

38. PSSP-ja pohon që OMiK-ut iu dha fillimisht prona në bazë të asaj se besohej që prona ishte shoqërore, duke u bazuar në të dhënat kadastrale që ishin parë në shkurt dhe korrik të vitit 2000 (shih § 16 më lart). Ankuesi deklaron që pas zënies së objekteve nga OMiK-u, ai menjëherë e informoi OMiK-un që objektet ishin të tij dhe që duhet bërë ndonjë formë e marrëveshjes për qira.

39. Megjithëse Panelit nuk i janë ofruar këto të dhëna kadastrale, ai nuk e kundërshton që në kohën kur iu dhanë objektet OMiK-ut për herë të parë, UNMIK-u besonte që objektet ishin pronë shoqërore. Megjithatë, Paneli thekson që deri më 23 prill të vitit 2005, ankuesi iu kishte paraqitur dëshmi për pronësinë e tij të dyjave, përkatësisht OMiK-ut dhe UNMIK-ut, duke i vënë ato në dijeni për natyrën e vërtetë të pohimit të tij. Sapo UNMIK-u ishte njoftuar për çështjen e pronësisë ndaj pronës, e kishte për detyrë të shqyrtojë dhe, nëse është e nevojshme, të korrigjojë natyrën e zënies nga OMiK-u. Prandaj, Paneli përfundon që dështimi i UNMIK-ut që të ndërmarrë veprim rregullues lidhur me pohimin sikur lidhja e kontratës për qira përbënte ndërhyrje të paligjshme nga UNMIK-u.

40. Në dritë të kësaj që u tha më lart, Paneli konstaton që ka pasur shkelje të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, për sa i përket zënies së paligjshme të objekteve në Pejë nga OMiK-u.

V. REKOMANDIME

41. Në dritën e gjetjeve të Panelit në këtë rast, Paneli mendon se është e nevojshme ndonjë formë e dëmshpërblimit.

42. Panel rekomandon që UNMIK-u duhet të ndërmarrë hapa të duhur vis-à-vis OSBE-së që ta kompensojë ankuesin për dëmin në para.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli, unanimisht,

1. KONSTATON SE KA PASUR SHKELJE TË NENIT 1 TË PROTOKOLLIT NR. 1 TË KONVENTËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT.

2. REKOMANDON QË UNMIK-u:

a. TË NDËRMARRË HAPA TË DUHUR VIS-À-VIS OSBE-së QË TË KOMPENSOJË ANKUESIN PËR DËMIN NË PARA;

b. TË NDËRMARRË MASA TË MENJËHERSHME DHE EFEKTIVE PËR T'I ZBATUAR REKOMANDIMET E PANELIT, DHE TË INFORMOJË ANKUESIN DHE PANELIN RRETH ZHVILLIMEVE TË MËTEJME PËR KËTË RAST.

Andrey ANTONOV
Zyrtar ekzekutiv

Marek NOWICKI
Kryesues

SHKURTESAT DHE AKRONIMET

CCIU – Njësiti Qendror për Hetim Penal
CCPR – Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
DOJ – Departamenti i Drejtësisë
DPPO – Zyra e Qarkut e prokurorit publik
ECHR – Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ECtHR- Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
EU – Bashkimi Evropian
EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë
FRY – Republika Federale e Jugosllavisë
GC – Dhoma e Lartë e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
HRAP – Paneli Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut
HRC – Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut
IACtHR– Gjykata Ndër-Amerikan për të Drejtat e Njeriut
ICMP – Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur
ICRC – Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq
ICTY – Tribunali Ndërkombëtar për Krime të Luftës në ish-Jugosllavi
KFOR – Forca Ndërkombëtare e Sigurisë (zakonisht e njohur si Forca e Kosovës)
KLA – Ushtria Çlirimtare e Kosovës
MoU - Memorandum i mirëkuptimit
MPU – Njësiti për Persona të Zhdukur
NATO – Organizata e Traktatit të Atlantikut të Veriut
OMPF – Zyra për persona të zhdukur dhe mjekësi ligjore
OSCE – Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RIU – Njësiti Rajonal për Hetim
SRSG – Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
UN – Kombet e Bashkuara
UNHCR – Komisariati i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatë
UNMIK – Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë
VRIC – Komisioni për Gjetjen dhe Identifikimin e Viktimave
WCIU – Njësiti për Hetim të Krimeve të Luftës